



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KOLONJË**

**ADRESA: SHESHI RILINDJA ERSEË**

**TELEFON : 081222225: 2232**

---

**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM**

**2021-2023**

**BASHKIA KOLONJË**  
**RELACION**  
**PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM**  
**2021-2023**

**I. HYRJE .**  
**MISIONI**

1. Misioni i këtij buxheti për Bashkinë Kolonje është gjithpërfshirës, i paanshëm, perceptues, transparent, dhe është harartuar mbeshtetur në ligj, për sigurimin e një qeverisje të efektshme,efikase, në një nivel sa më afër komunitetit nëpërmjet :
  - Njohjes së vlerave të bashkisë .
  - Zgjidhjes dhe ofrimit të llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe krijimi i lehtësirave të tjera publike në dobi të komunitetit .
  - Ushtrimin e funksioneve ,kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetqeverisjes vendore.
  - Realizimit të shërbimeve në forma të përshtatëshme , bazuar në nevojat e komunitetit .
  - Realizimin e shërbimeve në përputhje me standartet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative .

**Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm**

**Programi Buxhetor Afatmesëm ( PBA ) është një instrument operacional** për menaxhimin e shpenzimeve publike dhe një komponent kyç i Sistemit të planifikimit të integruar .Ai është rezultat i dy proceseve

- 1.Rishikimi i politikave
- 2.Planifikimi i shpenzimeve dhe investimeve të programit

**A.Qëllimet kryesore të PBA –së janë :**

1. Zbatimi i prioriteteve kryesore të qeverisjes nëpërmjet planifikimit dhe menaxhimit të financave vendore dhe shërbimeve për një periudhë tre vjeçare .
2. Planifikimi me efektivitet,eficësë dhe ekonomicitet në kryerje e shpenzimeve publike .
3. Planifikimi i shpenzimeve brenda një kuadri ligjor realist duke zbatuar një disiplinë fiskale maksimale.
4. Buxhetimi 3- vjeçar të jetë sa më realist për përmbushjen e objektivave dhe qëllimeve të programit .
5. Përgatitja e kërkesave buxhetore në kuadër të PBA-së duhet bërë me qëllim që të sigurojë shpërndarjen e foneve buxhetore duke reflektuar qëllimet e politikës gjatë një periudhe afatmesme tre vjeçare ,duke bërë lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet shpërndarjes së buxhetit dhe objektivave të politikeë së programeve .
6. Përgatitja e buxhetit vjetor është pjesë përbërëse e procesit të përgatitjes së PBA-së ,si dhe do të jetë viti i parë i këtij programi.

**B.Kërkesat buxhetore të cdo njësie të vetqeverisjes**

**Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi i parashikimit të PAB-së 2021-2023.**

Parashikimit afatmesëm i të ardhurave dhe shpenzimeve për Bashkinë Kolonje është i përgatitur në mbështetje të ligjit:

- a. Ligjit nr.115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative Territoriale të Njësive
- b. Ligjit Nr 9632 datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- c. Ligjit Nr 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën eShqipërisë”, i ndryshuar
- d. Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- e. Nr. 68/2017 Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore .
- f. Ligjit nr 9936 datë 26.06.2008 “për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”
- g. Ligjit nr 9975 datë 28.07.2008, ”Për Taksat Kombëtare”
- h. Udhëzimet për përgatitjen e PBA vendor 2021-2023 me nr 10 datë 28.02.2020, si dhe udhëzimit nr 27, datë 10.07.2020” Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023 dhe buxhetin vjetor 2021,Udhezimit nr 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të buxhetit , tavanet e ndryshuara të cilat janë miratuar me VKB nr 98, datë 07.07.2020,miratuar nga institucioni Prefektit të Qarkut Korçë me shkresën nr 726/2 ,datë 11.08.2020.

**Vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave dhe shpenzimeve janë mbështetur në nenin 34 të ligjit nr.68/2017 “ Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” ku thuhet:**

Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për:

- a) dy vitet para vitit buxhetor;
- b) vitin buxhetor;
- c) tre vitet e ardhshme buxhetore.

2. Në këtë raport përfshihen:

- a) metodologjia e përdorur për parashikimet afatmesme të të ardhurave;
- b) analiza të efekteve të politikave të reja fiskale ose të ndryshimit të atyre ekzistuese;
- c) analiza e risqeve dhe masave për përbalimin e tyre.

**1.Vështrim i përgjithshëm.**

**1.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore**

- Bashkia Kolonje është pjesë e Qarkut të Korçës dhe kufizohet me Bashkinë Korce, Devoll , Skrapar dhe Permet.
- Ka një sipërfaqe 864 km<sup>2</sup> e një popullsi 18.683 banorë dhe familje 6.379.
- Ajo përbëhet nga 5 Njësi Administrative (NJA):
- Erseke. Nj Qender Ersekë , Mollas -Çlirim , Navoselë - Barmash , Leskovik Qëndër dhe Leskovik .
- Në përbërje të tyre këto NJA përfshijnë gjithsej 2 qytete Ersekë dhe Leskovik si dhe 3 njësi administrative me 74 fshatra në total . Popullsia është shpërndarë në gjithë teritorin e Bashkisë ku dëndësia më e madhe është në qytetin e Ersekës dhe Leskovikut të cilat perfaqesojnë 48 % te popullsisë të Bashkisë Kolonjë . Ky përqendrim i popullsisë rrjedh si nevojë e komunitetit për akses ndaj shërbimeve mes qendrave urbane, poleve ekonomike te vendit etj..

**Familjet.**

Bashkia Kolonjë përbehet nga 6.379 familje e ku peshën më të madhe e zë Qyteti i Erseke dhe Leskovikut me 3.486 familje ose 54.64%

Aktualisht trajtohen me ndihmë ekonomike 315 familje nga këto 284 nga sistemi i ndihmës ekonomike dhe 31 nga 6% i bashkisë ose 4.94% të familjeve totale nga 5.19 % në vitin 2020 me një zbritje prej 0.25 %, gjithashtu trajtohen 813 persona me aftësi të kufizuar(PAK+ verberi+ tetraplegjike ) ose 4.35% te totalit te banorve

### ***Biznesi.***

Në territorin e Bashkisë Kolonje ushtrojnë aktivitetin e tyre 305 biznese nga të cilat 263 janë aktivë të biznesit të vogël dhe 42 janë subjekte të biznesit të madh si dhe 31 janë subjekte shtetërore që paguaj taksat .

### ***Arsimi***

Bashkia Kolonjë ka 20 shkolla nga të cilat 3 të arsimit të mesëm ,1 gjimnaz dhe 2 shkolla të mesme të bashkuara , 16 institucione të arsimit parashkollor nga të cilat 2 kopshte në qytetin Ersekë dhe 14 institucione janë në varësi të shkollavë përkatëse .

Numri i klasave në total është 95 ,me 1163 nxënës dhe 140 mësues ,nxënës në të mesme 263 dhe arsimin e mesëm i ulët 321 , në arsimin fillor 388 dhe 191 nxënës në kopshte Mesues në arsimin e mesëm 21, të mesëm ulët janë 58 , në arsimin fillor 32 , dhe në arsimin parashkollor janë 29 mësues.

### ***Bujqësia dhe blegtoria.***

Sipërfaqja e tokës bujqësore gjithsej figuron 11.185 ha, nga të cilat 7.242 ha tokë arë e ndare me ligjin 7501 dhe pjesa tjetër 3.943 ha është tokë shtetërore e pa ndare Nga kjo toke e mbjelle 4.800 ha ,arë 4.438 ha , pemtore 195 ha dhe vreshtë 126 ha dhe 41 ha bimë medicinale.

Në lidhje me blektorinë në Bashkinë Kolonjë kemi 88.388 krerë gjithsej nga këto gjedhë gjithësej 6911, te imta 45859 , blete 9772 , shpende 24259, dhe një thundrake 1587.

## **1.2 Çështje kryesore për projektet dhe politikat e bashkisë**

Bashkia Kolonjë aktualisht ka një Plan të Përgjithshëm Vendor të miratuar në vendim të Keshillit nr 29, datë 23.04.2019 për 15 vitete e ardhshme .Ky plan synon zhvillimin , sistemimin dhe përmirësimin e gjendjes ekzistuese të vendbanimit dhe cilësisë së jetesës së banorve në territorin e bashkisë..

Finalizimi i Planit të Përgjithshëm Vendor është një ndër arritjet kryesore në fushën e planifikimit të territorit të një bashkie të re, të krijuar pas reformës territoriale dhe me dëshirën e vullnetin për t'iu përgjigjur nevojave dhe kërkesave afatgjata të qytetarëve, si dhe për të përballuar sfidat e një zhvillimi të qëndrueshëm të territorit.

Në lidhje me Projekt-Buxhetin Afatmesëm 2021-2023 kemi përcaktuar transparencën e financave publike e cila preket edhe në strategjinë e menaxhimit të financave publike, vizioni i së cilës është të krijojë një sistem llogaridhënie, disiplinë fiskale dhe efikasitet në administrimin dhe përdorimin e fondeve me qëllim final të zhvillimit ekonomik të njësisë. Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë Kolonjë është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të të gjithë zonës urbane dhe rurale e cila lidhet me funksionet respektive të pushtetit vendor të përcaktuara.

Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga grupet e punës dhe drejtuesit e çdo programi buxhetor . Bazë e prioriteteve tona kanë qënë kërkesat e qytetarëve ,problematikat e evidentuara nga stafi i bashkisë , vazhdimësia e punëve,shërbimeve ,investimeve të nisura në vitin 2020, e cila shpreh një lidhje organike të buxhetit të vitit 2020 me PBA-në 2021-2023 ( përjashtimit ky vit ndodhur në kushtet e

pandemisë Covid 19 nuk na mundësoi dëgjesat publike në masë të gjerë ) por puna e administratës, e administratorëve e drejtueve të fshatrave na mundësuan problematikat dhe nevojat të cilat u reflektuan në objektiva dhe treguesit e PBA-se 2021-2023.

Hartimi i PBA përbën një proces shumë të rëndësishëm për ne ,pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshëm përmes të cilave objektivat tona bëhen të realizueshme, të matëshme , të krahasueshme dhe me produktivitet .

Buxheti në qëndër të vëmendjes do të ketë qytetarin, rritjen e mirëqënies, rritjen ekonomike, rritjen e aksesit dhe të cilësisë të jetës , duke rritur besimin e dyanshëm, gadishmërinë për të kontribuar , rritjen e cilësisë së rrugëve , mosshpopullimin e zonave rurale .

### **Qëllimet e PBA-së**

-Shpërndarja efektive e burimeve.

-Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit.

-Parashikim më i mirë buxhetor mbështetur në objektiva dhe prioritete për një periudhë 3-vjecare, me trgues performancë të matshëm dhe të krahasueshëm .

-Rritja e efektivitetit dhe eficensës së shpenzimeve publike.

-Forcimi i disiplinës fiskale.

### **Objektivat e PBA-së.**

a.Përmirësimi i menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritja e eficensës së përdorimit të fondeve buxhetore është objektivi parësor i PBA-së,në funksion të të cilit angazhimi dhe mbështetja me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesmarëse ngelet thelbësore në ecurinë e suksesshme të këtij procesi.

b.Sigurimi i një shpërndarje dhe përdorimi efektiv dhe eficient i burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet. një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,forcimi i lidhjes mes programeve dhe alokimit të burimeve.

### **PRIORITETET AFATMESME 2021-2023**

- Prioritetet afatmesme të reflektuara në PBA 2021-2023 janë mbështetur në kërkesat e qytetarëve dhe programin e Kryetarit të Bashkisë Kolonje dhe P P V.
- Prioritetet e PBA-së.
- Objektivi themelor i PBA –së do të jetë zhvillimi ekonomik - bujqësor i zones nëpërmjet përmirësimit të të gjithë infrastrukturës i cili ka qenë problem ndër vite.
- Ky objektivi do të realizohet përmes investimeve konkrete në fushën e bujqësisë, nëpërmjet ndërtimit të pritave , mirëmbajtjes së kanaleve kulluese dhe uitëse ,sistemimit të rrugëve bujqësore nëpër parsela ,sistemit rrugor të mirëmbajtur , mbrojtjes së mjedisit , rehabilitimit të objekteve shkollore ,fuqizimit të rinisë dhe shtresave në nevojë, përmirësimit të institucioneve kulturore-artistike,sportive ,nxitjes së biznesit ,ritjes së punësimit dhe zhvillimit ekonomik .

### **Shtyllat kryesore dhe synimet do të jenë si më poshtë:**

- ❖ Zhvillimi ekonomik i qytetit Ersekë , Leskovik dhe Njësive Administrative
- ❖ Zhillimi i agro turizmit dhe i turizmit
- ❖ Nxitja e punësimit dhe sipërmarrjes në agroturizëm (bizneset e reja në agroturizëm do te ndihmohen me subvencionimim për 3 vjet të sigurimeve shoqërore )
- ❖ Ofrimi i shërbimeve cilësore

- ❖ Përmirësimi i infrastrukturës rrugore rurale
- ❖ Garantimi i pastërtisë dhe reduktimi i ndotjes
- ❖ Rigjallërimi i jetës kulturore dhe sportive, në veçanti të sportit të moshave dhe ekipeve zinxhir.
- ❖ Rehabilitim i objekteve arsimore ,administrative,sociale
- ❖ Projektet strategjike

Këto projekte do të realizohen me mbështetjen e Qeverisë Shqiptare dhe donatorëve të ndryshëm .

Objektivat kryesore të Bashkisë Kolonje kanë të bëjnë me hartimin dhe menaxhimin e projekteve të zhvillimit strategjik ,krijimin e standartit të lartë të komunikimit me publikun, vlerësimin e problematikave ,ndjekjen dhe zgjidhjen përfundimtare të tyre duke afuar shërbime maksimale ndaj komunitetit .

### **1.3 Informacion financiar**

Vlerësimi dhe parashikimi afatmsëm i të ardhurave dhe shpenzimeve është mbështetur në nenin 34 të ligjit Nr 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”

Raporti për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave është bazuar mbi realizimet e viteve të fundit dhe të pritshmin e vitit buxhetor ,për këtë qëllim kemi përdorur dhe metodologjinë afatmesme të parashikimit të të ardhurave ,ndryshimet ligjore për paketën fiskale si dhe analizën e risqeve dhe masat për përbalimin e tyre.

Të ardhurat veta e planifikuara për vitin 2021 përbëjnë 26.48% të totalit të burimeve , ose 39.67 % të fondit të bashkisë (transfertë e pakushtëzuar + të ardhurat e veta ) .

Më krahasimi me të ardhurat e planifikuara për vitin 2020 të ardhura e vetë janë rritur me 0.52 % .Të ardhurat nga taksat lokale zënë 16 .98 % ndaj të ardhurave totale ,Të ardhurat nga tarifat vendore zënë 69.36 % të totalit të të ardhurave ,të ardhurat nga taksat e ndara zënë 4.62% të totalit, të ardhurat nga dhënjet më qera e asetve 9.04% .

Të ardhurat nga burimet e veta për vitin 2022 janë parashikuar me një rritje prej 0.55 % ndaj vitit 2021, dhe për vitin 2023 krahasuar me vitin 2021 nuk kanë rritje pasi në vitet 2020-2021 dhe 2022 kemi miratuar tarife turizmi e perkohëshme vetëm për 3 vite .

Theksojmë së peshën më të madhe të të ardhurave të veta të bashkisë e zënë të ardhurat nga tarifat vendore .

Llogaritja e planit të të ardhurave është mbështetur në llogaritjen e kapacitetit të taksave dhe tarifave, si dhe realizimit në vite të më parshme,si dhe forcimit të disiplineve fiskale ,dhe politikat e përcaktuara për periudhën në vijim duke u mbështetur në aktet ligjore në fuqi. Parashikimi i të ardhurave në periudhën afatmesme reflekton dhe ndryshimet e paketës fiskale për efekt të ndryshimeve ligjore por edhe për efektin e pjesës debitore nga vitet e mëparshme arketimi ityre ka influence në realizimin e të ardhurave .

Në punën e Drejtorisë së të Ardhurave do kihet parasysh minimizimi i informalitetit dhe rritja e numrit të tatimpaguesve ,vecanërisht atyre familjarë me të cilët kemi hasur më shumë problem , por ndodhur në kushtet e pandemisë Covit 2019 këtë vit kemi hasur vështirësi në arkëtimin e të ardhurave kryesisht nga bizneset të cilët pretendojnë

## **2.Orientimi afatgjatë i bashkisë nga PPV**

### **2.1 Strategjia e zhvillimit afatgjatë/strategjia territorial.**

**Investimet kapitale të parashikuara për tu realizuar në Bashkinë Kolonjë gjatë zbatimit të P PV janë klasifikuar në tre grupe kryesore.**

Në lidhje me zhvillimin afatgjatë të Bashkisë Kolonje ne do të synojmë një zhvillim ekonomik bujqësor të të gjithë zonës të parashikuar në P P V.

Objektivat tona do të synojmë zhvillimin në fushat e mëposhtme:

Objektivat sipas planit strategjik të zhvillimit:

▪ **Përmirësimi i infrastrukturës publike**

- a. Mbështetja për infrastrukturë rrugore
- b. Rivitalizime hapësirash publike/urbane
- c. Infrastrukturë komunitare
- d. Shërbime publike
- e. Infrastrukturë mjedisore
- f. Infrastrukturë turistike
- g. Monumente të trashëgimisë kulturore
- h. Qendra multifunkionale komunitare
- i. Peizazhi mjedisor

▪ **Zhvillimi ekonomik nëpërmjet diversifikimit të aktiviteteve ekonomike**

- a. Përmirësimi i potencialit turistik në hapësirat rurale
- b. Agroturizëm dhe turizëm rural
- c. Investime në përmirësimin e shërbimeve tregtare
- d. Investime në prodhimin e produkteve tradicionale
- e. Shërbime të tjera ekonomiko - financiare
- f. Mbështetje për ikubatorë të produkteve rurale tradicionale
- g. Promovim dhe marketim i zonave rurale
- h. Shërbime transporti
- i. Panairë dhe festa lokale

▪ **Zhvillim i kapitalit social dhe njerëzor**

- a. Mbështetje për krijimin e rrjeteve rurale, grupeve lokale të veprimit si dhe shoqërisë civile në zonat rurale
- b. Trajnim profesional për të rinjtë dhe gratë
- c. Mbështetje të trashëgimisë kulturore

Në objektivat strategjik të planit parashikohet ,sigurimi i integritetit fizik të teritorit të peisazhit historik ,kulturor,natyror dhe urban në të gjithë territorin .Në përputhje me planin e përgjithshëm vendor dhe strategjinë territoriale bashkëngjitur tij gjithashtu dhe me prioritetet e sygjera nga titullari i bashkisë u parashtruan xxxxx projekte investimesh të shtrira në kohe përkatesisht në vitin 2021 2022,2023, Eshtë parë me prioritet sektori i turizmit ,i shërbimit dhe aspekti urban në nivel qytetesh përkatesisht në Ersekë dhe Leskovik .

Nëpërmjet implementimit të këtyre projekteve synohet të përmiresohet cilesia e jëtes në lokacionet e nderhyrejes ,të promovohet turizimi bazuar në destinacionet e etiketuara ku vizitorët ti gëzohen bukurive natyrore dhe ofertës cilësore e të shumëllojshme turistike dhe të

ndëryhet me efikasitet në kohë dhe në cilësi në veprat inxhinjerie (të tipit kanale ujites, segmente rrugesh rurale etj).

Investimi publik kryhet nga/ose në emër të sektorit publik dhe realizohet nëpërmjet projekteve të investimeve. Projekti i investimit, si pjesë e një Programi të Shpenzimeve Publike, është një grup aktivitetesh të projektuara për të realizuar produkte të caktuara, brenda një afati kohor.

Fakti që mundësitë dhe potenciali financiar është i vogël kushtëzon që efektiviteti dhe eficientia e investimeve të përbëjnë një sfidë jashtëzakonisht të rëndësishme si aktuale ashtu dhe në të ardhmen. Nisur nga ky fakt parashikimet, synojnë të evidentojë dhe të realizojë një analizë aktuale të gjendjes së investimeve dhe të treguesve të eficientës në veçanti.

Përzgjedhja është bërë bazuar në analizat e detajuara e zonave urbane si vijon :

- Analiza e detajuar e infrastruktures
- Evidentimi i nevojave për shërbime në bazatë trendeve demografike
- Identifikimi i sipërfaqeve të nevojshme për të realizuar plotësimin e kërkesës për banesat dhe shërbime.
- Një synim i joni në të ardhmen do të jetë edhe zhvillimi bujqësor dhe vecanërisht ifrutikulturës në toka të cilat ende janë të pandara dhe janë në pronësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural apo organit të vetëqeverisjes vendore. Në projektet e identifikuarat renditen dhe projektet të cilat nuk janë kompetencë e Bashkisë por që kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e Bashkisë Kolonje ku vlerësohet se 25 % e projekteve duhet të financohet nga investimet private, bashkia dhe pushteti qendror dhe si bashkefinancim bashki pushteti qendror, dhe bashki me privat. Duke parë situatën ekonomike dhe pamundësinë e financave të bashkisë Kolonje dhe rritjes graduale të ekonomisë implementimi i projekteve do të shtrihet në fazat e ndryshmeve ku secili investitor do të japë kontributin e tij. Duke patur parasysh nevojën e harmonizimit të buxhetit afat mesëm të bashkisë vlerësohet se investimet mund të ndahen në disa faza.

## **2.2 Sfidat kryesore të zhvillimit**

- Plani i Përgjithshëm Vendor të cilin e kemi miratuar ka pjesën e vet dhe strategjinë e zhvillimit ekonomik të njesisë tone. Plani Strategjik i Zhvillimit do të synojë një planifikim dhe menaxhim sa më të mirë të financave, resurseve dhe shërbimeve për një periudhë gati 15 –vjeçare. Vetë PBA do të jetë pjesë e këtij plani strategjik dhe do të ketë qëllim kryesor në vetvete efektivitetin dhe eficientinë e financave vendore, ekonomisë dhe kryerjen e shpenzimeve publike sa më afër qytetarit.

- Lidhja e drejtpërdrejtë midis prioriteteve strategjiko–politike të qeverisë me shpërndarjen e burimeve publike të rakorduara me ato të bashkisë tonë do të jetë synim për të ardhmen.

- Projekt Buxheti Afatmesëm do të jetë i orientuar mbi bazën e performancës së organit të vetëqeverisjes vendore duke përgatitur kërkesa buxhetore sa më realiste në kuadër të PBA-së dhe Planit të Përgjithshëm Vendor me qëllim që të sigurojë një shpërndarje të fondeve buxhetore e të reflektojë qëllimet e politikës gjatë një periudhe afatmesme 3-vjeçare.
- **Është e rëndësishme të theksojmë që buxhetit vjetor 2021 është pjesë përbërëse e programit buxhetor afatmesëm.(PBA 2021-2023).**



- Sfidat kryesore të zhvillimit do të jenë primare në punën tonë të përditshme duke patur si bazë një plan të pergjithshëm sa më realist,gjithëpërfshirës dhe sa me afër komunitetit.

## F15 SHPENZIMET KAPITALE

Prog	Emertimi i prog	2018	2019	2020	2021	2022	2023
Prog 1	Organet ekzekutive dhe legjislativ,çështjet financiare dhe fiskale dhe çështjet e brendëshme	10.298	6.200	500	5.000	6764	4.000
Prog 7	Bujqësia , pyjet ,peshkimi dhe gjuetia	38.221	21.291	7.792	8970	5200	6790
Prog 8	Trasporti	33.667	0	0	0	0	
Prog 10	Industri te tjera				1.500	2.000	2.000
Prog 10	Menaxhimi I mbetjeve	15.031	18.433	0	0	0	0
Prog 15	Zhvillimi I komuniteti	0	0	7.250	9.200	16.352	19.000
Program 16	Ndricimi				2.500	2.000	2.000
Prog 20	Shërbimet kulturore	0	1.500	0	0	0	
Prog 21	Arsimi baze dhe parashkollor	30.385	1.300	0	0	0	
Prog 22	Arsimi parauniversitar	2.993	0	43.204	2.156	1.878	1.878
		124.595	48.724	58.746	29.326	31.430	38.432

## Lista e investimeve për vitin 2021

000/lekë

Nr	Emërtimi i investimi	vlera
1	Pika panoramike	1.500
2	Prita	600
3	Lera	900
4	Plan mbarështimi	1.100
5	Rikonstruksion I kanalit ujitës Leskovik	1.500
6	Rikonstruksion I kanalit ujitës Ersekë – Taç Poshtë	1.800
7	Shtim haperisra të gjelbëruara Blloku nr 2	1.000
8	Rikualifikim I rrugës “ Pali Prifti	5.000

9	paisje	70
10	Rikonstruksion çatie dhe sistem ngrohje godina e bashkisë	5.000
11	Rikonstruksion trotuaresh	3.200
12	Blerje kamioni	3.000
13	Ambjente sportive	2.156
14	Ndricimi LED	2.500
	<b>Totali ivnetimeve</b>	<b>29.326</b>

**Dhe vazhdimi I investimeve të FZHR per vitin 2021 shpjeguar ne relacionin e buxhetit të vitit 2021 si dhe fondet e investimeve nga IADSA.**

### **Lista e investimeve për vitin 2022**

Nr	Emertimi i investimit	vlera
1	Aplikaxioni dixhital I turizmit	2.000
2	Prita	600
3	Lera	600
4	Plan mbarështimi	700
5	Rikonstruksion I kanalit ujitës leskovik	1.600
6	Rikonstruksion I kanalit ujitës Ersekë – Taç Poshtë	1.700
7	Shtim haperisra të gjelbëruara Blloku nr 1	1.000
8	Rikualifikim I rrugës “ Pali Prifti	12.352
9	Ndricim LED ne qytetin Ersekë	2.000
10	Rikonstruksion I tereneve sportive pranë shkollës “ Petro Ninin Luarasi “ Ersekë	1.878
11	Rikonstruksion çatie dhe sistem ngrohje godina e bashkisë	2.262
12	Blerje paishjesh	1.738
13	Rikonstruksion trotuaresh	3.000
	Tatal I investimeve	31.430

### **Lista e investimeve për vitin 2023**

Nr	Emertimi i investimit	vlera
1	Hartim strategjie për turizmin	2.000
2	Prita	1.000
3	Lera	1.290
4	Plan mbarështimi	1.200
5	Rikonstruksion I kanalit ujitës leskovik	1.600
6	Rikonstruksion I kanalit ujitës Ersekë – Taç	1.700

	Poshtë	
7	Shtim haperisra të gjelbëruara Blloku nr 3	1.000
8	Rikualifikim I rrugës “ Pali Prifti	5.000
9	Rikualifikim I qëndrës fshati Mollas	10.000
10	Ndricim LED ne qytetin Ersekë	2.000
11	Rikonstruksion I tereneve sportive pranë shkollës “ Mustafa Jashari “ Mollas	978
12	Vendosje kënd lodrash tëk kopshti nr 2	900
13	Blerje paishjesh	4.000
14	Hartim projektesh	1.364
15	Rikonstruksion trotuaresh	3.000
16	Mbikqyrje	1.400
	Tatal i investimeve	<b>38.432</b>

#### **4. Informacion financiar**

##### **4.1 Supozimet e planifikimit**

Treguesit e rritjes ekonomike varen nga rritja e fondeve buxhetore nga të gjitha burimet, Transferta e Pakushtëzuar, është ritur 1.83 % për vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 ,Transferta specifike është ritur 2.86 % në krahasim me vitin 2020, të Ardhurat veta të Planifikuara janë ritur me 0.52 %, Fondet e Deleguara, Fondet e çelura nga buxheti i shtetit për investime, po ashtu theksojmë se me shtesë është transferta e pakushtëzuar dhe pëe vitet 2022 dhe 2023, trasferta sektoriale e pa ndryshuar. E vecanta për vitin 2021 është celja nga qeveria e fondit të emergjencës në shumën 2.271 mijë lekë.

##### **4.2 Burimi i të ardhurave**

- A. Totali I burimeve të financimit për vitin 2021 kap shifrën 532.170 mijë lekë nga të cilat trasferta e pakushtëzuar 122.401 mijë leke , të ardhurat e veta 80.470 mijë leke trasferta specifike 98.745 mijë lekë , të deleguarat 4.598 mijë lekë dhe emergjenca 2.271 mijë, fondet nga FSHR dhe te tjera shuma 223.685 mijë.
- B. Për vitin 2022 trasferta e pakushtëzuar kap shifrën 123.323 mijë lekë, trasferta e kushtëzuar 98.745 mijë lekë , të ardhurat e veta 80.915 mijë lekë , të deleguarat 4.598 mijë lekë , emergjenca 2.271
- C. Për vitin 2023 trasferta e pakushtëzuar 132.598 mijë lekë , të ardhurat e veta 80.471 mijë lekë , trasferta e kushtëzuar 98.745 mijë lekë , të deleguarat 4.598 mije lekë , emergjenca 2.271 mijë lekë.

Në lidhje me të ardhurat e vetë bashkisë ,pavarsisht se në pamje të parë duket se nuk ka rritje shumë të ndjeshme ,sqarojmë se jemi në të njëjtat nivele me një vit më parë. Në këtë aspekt sqarojmë se po të bëjmë një krahasim midis viteve ka një rritje jo vetëm në planifikim e te ardhurave por realizimin e planit të të ardhurave te krahasuar me nje vit me pare .

Kështu viti 2018 ka një realizim 51.608 mijë lekë ,

Në vitin 2020 i pritëshmi i realizimit të të ardhurave do të jëtë 56.000 mijë lekë ose në krahasim me plani do të realizohen në masën 69.57 % . Mosrealizimi më i madh vjen nga situatë Civid-19 dhe moshlyerja e detyrimeve nga biznesi I vogel

Dhe në krahasim me planin e vitit 2019 realizimi i të ardhurave është 80 % . Ritja e të ardhurave në krahasim me vitin 2019 ka ardhur si rezultat i ritjes së arketimit të detyrimeve dhe regjistrimi i subjekteve të pa licensuar .

Parshikimi i të ardhurave për vitet 2021, 2022 , 2023 , në krahasim me të pritëshmin e vitit 2020 kanë një rritje me 3.64 % për vitin 2021, 1.75% në vitin 2022, 1.72 % për vitin 2023 Për më tepër shif program buxhetor burimin e të ardhurave .

Të ardhurat nga buxheti qëndror rezulton që transferata e pakushtëzuar nga 120.195 mijë për vitin 2020 shkon në 122.401 mijë për vitin 2021 ose 2.206 mijë lekë më shumë dhe për vitet, 2022, 2023 është në rritje në krahasim me vitin 2021.

Trasferata e pakushtëzuar sektoriale për të treja vitet është me shtesë 2.743 mijë lekë dhe ato të deleguar janë në nivelet e treguesve të vitit 2020 .

### **4.3 Shpenzimet**

- A. Shpenzimet totale për vitin 2021 kapin shumën 532.170 mijë lekë ,
- B. Për vitin 2022 shpenzimet kapin shumën 309.852 mijë lekë
- C. Për vitin 2023 kapin shumën 318.638 lekë shpenzimet të cilat janë të barabarta me burimet e financimit .
- D. Tabelat e PBA 2021-2023 shprehin dhe me shifra dhe me grafike të gjithë treguesit që do të realizohen në këtë PBA.

#### 4.4 Rezultati total i buxhetit

##### **4.4.1 Detyrime të prapambetura**

Detyrimet e prapambetura prej 10.175 mijë lek janë planifikuar të shlyhen për vitin 2021-2023. Vlera prej 10.175 mijë lekësh janë detyrime të trashëguara nga vitete e kaluar dhe veçarisht vendimet gjyqësore të cilat kapin peshën më të madhe në totalin e detyrimeve të cilat janë planifikuar të shlyhen 5.000 mijë në vitin 2021, 5.000 mijë në vitin 2022 dhe 175 mijë në vitin 2023. Theksojmë se që në vitin 2020 kemi punuar për zbutjen e detyrimeve dhe moskrijimin e detyrimeve të reja .

##### **4.4.2 Rreziqet financiare dhe fiskale**

Rreziqet financiare kanë të bëjnë më mosrealizimin e planit të të ardhurave si rezultat i mungesës të një numri të konsiderueshëm familjesh të cilat janë larguar nga bashkia në drejtime të ndryshme dhe pse kanë lejen e banimit në bashkinë tone ku dhe janë llogaritur detyrimet përkatëse. Po kështu problem ngelet dhe detyrimet e debitorve nga vitete e kaluar.

Për vitin 2020 është evidentuar si element risku pandemia ku si rezultat i saj kemi mosrealizim të ardhurash kryesisht nga biznesi juridik dhe fizik të cilët pretendojnë për vështirësi financiare , mungesë likuiditeti .

### **Analiza e shpenzimeve sipas programeve buxhetore , qëllimet , objektivat dhe treguesit e performancës .**

#### **011: Organet ekzekutive dhe legjislative, çështjet financiare dhe fiskale, çështjet e brendshme**

## **Vështrim i përgjithshëm i programit**

**Zhvillimi i njësisë ,menaxhimit financave të njësisë së vetqeverisjes** vendore ,të burimeve të tjera si dhe burimeve njerëzore ,funksionimi i proceseve të përgjithëshme të brendëshme dhe komunikimi me publikun

Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetqeverisjes vendore ose të këshillit .

01110 . Planifim, menaxhim dhe administrim

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithëshme për personelin.
- Shërbime të përgjithëshme për publikun , si shërbimet e prokurimit , mbajtja dhe ruajtja e dokumentave dhe arkivave të njësisë , ndërtesat në pronësi apo të zëna nga njësia ,zyrat e IT .
- Administrim ,funksionim dhe afrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë së vetqeverisjes vendore ,për këshillin ose komisionet e këshillit .
- Shërbimet statistikore dhe bazat e të dhënave vendore .
- Prodhim dhe përhapje e informacionit publik ,dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit .

## **Qëllim**

- ✓ Qeverisje vendore e përgjegjeshme dhe administratë transparente .
- ✓ Përmirësimi i kapaciteteve të bashkisë për ritjen e cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit

## **Objektivat**

1. Të rritet qëndrueshmëria në administratën civile .
2. Ritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve nr vendimarrje me 30% çdo vit .
3. Përmirësimi i stafit të bashkisë .
4. Përmirësimi i shërbimit dhe informacionit në një kohë të shpejtë dhe me cilësi nëpërmjet sistemit të zyrës me një ndalesë.
5. Sigurimi i kushteve optimal për të gjithë punonjësit e Bashkisë

## **Prokurti**

Punonjës të kualifikuar dhe staf transparent.

## **Treguesit e performancës .**

- ✓ Ritja e qëndrueshmërisë së administratës civile që ka të bëjë me nr e punonjësve që lëvizin brenda vitit në krahasim me nr total të punonjësve .
- ✓ Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë që ka të bëjë me masat disiplinore të mara nga stafi i bashkisë .
- ✓ Sigurimi i kushteve optimal për punonjësit nëpërmjet investimit për rikonstruksionin e godinës së bashkisë dhe zyrave të saj.

## **Kostoja**

Viti 2021 = 42.573 mijë lekë nga keto Paga dhe sigurime 21.181 mijë lekë, shpenzime korrente 16.392 mijë lekë, kapitale 5.000 mijë lekë .

**Theksojmë se në shpenzimet korrente të këtij program janë planifikuar 5.000 mijë shpenzime për këshilltarët dhe kryepërgjithësi nga të cilat 4.500 mijë janë pagesat e shpërblimit mujor dhe 500 mijë shpenzime të cilat janë planifikuar nga Ju me buxhet më vete.**

**Në këtë program 13.296 mijë lekë janë nga të ardhurat e veta të bashkisë kërkesa neto 29.277 mijë.**

Viti 2022= 41.581 mijë lekë nga keto paga sigurime 21.181 mijë lekë, shpenzime korrente 16.400 mijë lekë, shpenzime kapitale 4.000 lekë.

Nga të ardhurat e veta do të shpenzohen 12.845 mije , kërkesa neto 28.845

viti 2023 = 44.445 mijë lekë nga keto Paga dhe sigurime 21.181 mijë lekë, shpenzime korrente 16.500 mijë lekë, kapitale 6.764 mijë lekë

• Në këtë program 12.175 mijë lekë janë nga të ardhurat e veta të bashkisë, kërkesa neto 32.270 mijë.

### **Rezultat**

Administratë e kualifikuar dhe traspatente .

### **Impakt**

Ofrim shërbimi me cilësi dhe në kohë për komunitetin

### **01120 . Çështje financiare dhe fiskale**

- Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale, menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore, i borxhit dhe funksionim i skemave të taksimit,
- Bashkërendimi me degën e thesarit , zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave.
- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.
- Planifikimi i përgjithshëm dhe shërbimet statistikore, duke përfshirë formulimin, bashkërendimin dhe monitorimin.

### **Qëllimi**

- ✓ Të rriten kapacitetet financiare për të mbështetur shërbimet ndaj komunitetit .

### **Objektivat**

1. Përmirësimi i financave të bashkisë nëpërmjet mbledhjes së të ardhurave të planifikuara nga taksat dhe tarifat vendore , duke punuar për uljen e informalitetit e cila con në ritjen e numurit të subjekteve të liçensuara .
2. Menaxhimi me efektivitet i të gjitha burimeve financiare duke ulur detyrimet e prapambetura të pa paguara.

### **Produkti .**

Të ardhura sipas planit , shëndoshjen e gjendjes financiare të bashkisë ,zbutje e detyrimeve të papaguara .

Kosto totale = 17.644 mijë për vitin 2021 nga të cilat pagat 11.154 mijë lekë, shpenzimet korrente 6.490 mijë lekë ,nga të ardhurat e veta 4.490 mijë , kërkesa neto 13154 mijë.

për vitin 2022 =13.623 mijë lekë ,paga dhe sigurimet 10.454 mijë,shpenzime operative 3.169 mijë , nga të ardhurat e veta 3.204 kërkesa neto 10.419 mijë.

për vitin 2023=13.373 lekë ,paga + sigurime 10.454, shpenzime korente 2.919, nga të ardhurat e veta 3.204 , kërkesa neto 10.169 mijë.

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Mbyllja e bilancit vjetor më një bilanc të drejtë midis të ardhurave dhe shpenzimeve të dalë jo negative .
- ✓ Përmirësimi i mbledhjes së të ardhurave të veta dhe ritja e të ardhurave nga menaxhimi i aseteve të bashkisë .

### **Rezultat .**

Bilanc vjetor pa defiçit (pa detyrime të prapambetura të pa paguara të cilat mbarten në buxhetin e vitit pasardhës ), të cilat çojnë në shëndoshjen e financave vendore.

### **01170 Gjendja civile .**

Fonde të pushtetit qendror për funksionin e deleguar të gjendjes civile , në njësitë e qeverisjes vendore .

#### **Qëllimi**

- Sigurimi I hedhjes ,rruajtjes dhe ndryshimit të përbërësve të gjendjes civile të shtetasve shqiptarë,të huaj dhe personave pa shtetësi me banim të përkohshëm apo të përhershëm ne RSH.

#### **Objektivat**

1. Sigurimi efikas dhe eficient I shërbimeve të gjendjes civile , duke përmirësuar shërbimin dhe shkurtrimi I kohës së marjes së shërbimit .
2. Ritja e të ardhurave të arkëtuara nga prodhimi i dokumentave të prodhuara .

#### **Produkti**

Shërbim I përmirësuar dhe shkurtrimi i kohës së shërbimit .

Kosto totale =2.860 mijë lekë për vitin 2021 vetëm për paga + sigurime ,2022=2.860 mijë lekë , 2023= 2.860 mijë lekë .

#### **Rezultati**

Shërbim cilësor për komunitetin

#### **Impakt**

Rit efektivitetin e kohës së punës për komunitetin për të gjitha moshat ,fëmijë, gra –bura dhe të moshuar .

### **03140 Shërbimet policore**

#### **Vështrim i përgjithshëm i programit**

- Sigurim, i mbrojtjes ,qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda teritorit të njësisë ne përputhje me dispozitë ligjiore.
- Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjera nga Kryetari dhe vendimet e Këshillit Bashkiak .

#### **Qëllimi**

- ✓ **Përmirësimi i sigurisë së komunitetit nëpërmjet shërbimit të policisë bashkiake**

#### **Objektivat**

1. *Ritja e cilësisë së shërbimeve bashkiake për sigurinë dhe qetësinë publike në komunitet duke rritur nr e trajnimeve për punonjësit e policisë bashkiake me te paktën 3 trajnime në vit .*
2. Marja e masave për parandalimin e të gjitha problematikave që kanë të bëjnë me rendin dhe qetësinëpunlike,,pronësi dhe menaxhimin e të gjitha konflikteve që kanë motive pronësie dhe që kërkojnë ndërhyrjen e policisëbashkiake me të
3. Ritje e rasteve te manaxhuara nga ana e policies bashkiake duke rritur dhe bashkëpunimin me policimë e rendit .

#### **Produkti**

Punonjës policie të trajnuar,nr raste konfliktesh të menazhuara .

**Kosto totale e programit** =6.158 mijë lekë për vitin 2021 nga këto paga =5.708 mijë lekë , shpenzime operative =450 mijë lekë ,nga të ardhurat e bashkisë 1987 mijë, viti 2022 = 6.158 mijë, paga + sigurime 55.708 mijë , shpenzime korente 450 nga të ardhurat 1987 mijë lekë dhe viti 2023=6.158 mijë lekë nga këto paga + sigurime 5.708 mijë , shpenzime korrente 450, nga të ardhurat e veta 1987 mijë, këkesa neto 4.171 mijë,

#### **Treguesit performance**

- ✓ 40 raste të konflikteve të menaxhuara
- ✓ 32 raste të raportimeve të popullatës tek policia bashkiake të menaxhuara
- ✓ Ruajtja e qetësisë publike , locale për zhurmat

### **Rezultati .**

Zgjidhje te konflikteve , shtimi i cilësisë së shërbimit në komunitet ,garatimin e sigurisë së pronës

### **Impakti**

Jetesë më e mirë , më e sigurt për të gjitha moshat fëmijë ,gra ,bura e të moshuar .

## **032: Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri**

03280 Mbrojtja nga zjarri

### **Vështrim i përgjithshëm i programit**

- Funksionimi i njësive zjarfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit .
- Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, evakuimi i zonave të përmytura etj.
- Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimeve dhe mbrojtjes kunder zjarrit .

### **Qëllimi**

- ✓ Është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

### **Ojektivat**

1. Përmirësimi i shërbimeve dhe infrastrukturës së shuarjes së zjarrit dhe shpëtimit nëpërmjet uljes së rasteve problematike ,reagim më të shpejtë ndaj njoftimeve për zjarrin ,përmirësimi të shërbimit të parandalimit të zjarrit duke ulur me 11 numurin e rasteve të menazhusra per vitin 2021 ,13 për vitin 2022 dhe 15 për vitin 2023.

### **Produkti**

Numri i rasteve të menaxhuara , koha e daljes nga stacioni , numuri i inspektimeve tek të tretët (privat dhe publik).

### **Aktivitetet.**

1. Hartimi grafikut të shërbimeve
2. Hartimi i grafikut të gadishmërisë
3. Procedura prokurimi
4. Zbatim kontratash

**Kosto e programit** =13.612 mijë lekë, nga këto paga +sigurime11.761 mijë ,shpenzime operative 1.851 mijë lekë për vitin 2021, e njëjtë për të treja vitet.

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Reagimi më i shpejtë ndaj njoftimeve për zjarret , me ndryshim sekondash të daljes nga stacioni
- ✓ Nr i stacioneve të MZSH



- ✓ Nr i inspektimeve dhe vizitave tek të tretët

### **Rezultatet**

Objekte, prona dhe jetë njerzish të shpëtuar.

### **Impakti**

Jetësë më e sigurt për të gjitha moshat ,si dhe pronë më te garantuar nga zjarri dhe përmbytjet .

### **3600 Mardhënie me komunitetin .**

- Akrivite të njësisë për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjellë dhe ndjenjën e përkatësisë Brenda njësisë ,besim dhe mbeshtetjen e autoriteteve vendore .
- Ritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarje nëpërmjet organizimit të aktiviteteve për këtë qëllim .
- Funksionimi i zyres me nje ndalesë në shërbim të qytetarëve dhe të biznesit .
- Programi mbulon marjen e masve për të ritur besimin e qytetarëve dhe marëdhënien e njësisë me komunitetin,ofrimin e shërbimeve sa më afër kërkesave dhe nevojave të qytetarëve .

### **Qëllimi**

- ✓ Komuniteti është aktiv në hartimin dhe zbatimin e politikave vendore duke ritur përfshirjen e komunitetit në vendimmarje .
- ✓ Përmirësim i shërbimit për qytetarët dhe biznesin ,informimin e tyre ,ritjen e transparencës ,lehtësimin e procedurave në kryerjen e procedurave administrative

### **Objektivat**

1. Ritja e pjesëmarrjes aktive të qytetarëve në vendimmarje me 30 % cdo vit
2. Ritja e konsultimeve me publikun me 22 % cdo vit .
3. Përmirësimi i shërbimit dhe informimit në një kohë të shpejtë dhe me cilesi nëpërmjet sistemit të zyrës me nje ndalesë.

### **Produkti**

Konsultime publike të shtuara dhe pjesëmërje e rritur e komunitetit në vendimmarje si dhe shërbime të shpejta dhe cilësore .

**Kosto totale** = 2.956 mijë leke për vitin 2021, nga këto paga 2.876 mijë lekë dhe 80mijë shpenzime korrente ,nga të ardhurat e veta 980 mijë , në vitin 2022=2.356 mijë lekë dhe 2.376 në vitin 2023.

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Komuniteti vendor i përfshirë në procesin vendimarrës , Nr i konsultimeve me popullin nga 12 konsultime cdo vit
- ✓ Rritja e nr te kekesë ankesave të pranuar në vit ,përkatësisht ,1000,1100,1400.
- ✓ Nr i rasteve të zgjidhura , përkatësisht 800,900 dhe 1000 sipas viteve

### **Rezultat**

Cdo qytetar merr informacion të saktë , më shkrim për kërkesën apo ankesën e paraqitur në një kohë më të shkurtër, nxit bashkinë për të cuar shërbimet sa më afër komunitetit.

### **Impakt**

Kursim i kohës për marje shërbimesh ,shmangie të korupsionit apo abuzimeve që lindin midis administratës dhe publikut , jetësë më e mirë dhe më e garantuar .

### **4130 Mbështetje për zhvillimin ekonomik (QKB )**

- Administrimi I ceshtjeve she shërbimeve të përgjithëshme ekonomike dhe tregëtare , forcimi I zhvillimit ekonomik dhe punësimit vendor , mbështetja edhe promovimi I bizneseve vendore në funksion të zhvillimit ekonomik brenda teritorit të njësisë.

### **Qëllimi**

- ✓ Lehtësimi i biznesit

### **Objektiv**

1. Përmirësimi i shërbimit ndaj biznesit dhe popullatës
2. Ulja e kohës për pajisjen me dokumenta publik

### **Produkti**

Sherbim mer në një kohë të shkurtër

**Kosto** = 1.738 mijë nga këto 1.652 mijë paga dhe 86 mijë shpenzime korrente për vitin 2021, 1.738 mijë viti 2022dhe 1.738 mijë viti 2023.

### **042: Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia**

#### **04220 Shërbimet bujqësore,inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e**

konsumatorëve

#### **Vështrim i përgjithshëm i programit**

- Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë,
- përmasat dhe pronësinë e parcelave.
- Prodhimi dhe përhapja e informacionit të përgjithshëm,dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet bujqësore.
- Administrimi dhe mbrojtja e tokës bujqësore dhe kategorive të tjera resurse .
- Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinare për blegtorinë.
- Kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorëve .

### **Qëllimi**

- ✓ Rritja e produkteve bujqësore dhe blegtorale .
- ✓ mbrojtja e tokës bujqësore nga gryerjet dhe përmytjet
- ✓ si dhe rritja e sigurisë ushqimore .

### **Objektivat**

1. Mbështetja e rritjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral nëpërmjet rritjes së numurit të inspektimeve dhe kontroleve në teren si dhe zgjidhjes së konflikteve pronësorë me 96 raste për vitin 2021,115 për viot 2022 dhe 130 për vitin 2023
2. Mbrojtja e tokës bujqësore nga përmytjet duke bërë 3 prita malore në vitin 2021 e cila mbron rreth 50 ha tokë,
3. Mbrojtja e tokës bujqësore nga përmytjet duke bërë 3 prita malore në vitin 2022e cila mbron rreth 45 ha tokë,

4. Mbrojtja e tokës bujqësore nga përmbytjet duke bërë 3 prita malore në vitin 2023 e cila mbron rreth 75 ha tokë.

### **Produkti .**

96 raste inspektive e saktësime dhe zgjidhje konflikt pronësie , 80 pronarë që paisen me certifikata pronësie dhe 3 prita malore funksionale për cdo vit dhe 170 ha tokë të mbrojtur nga gëryerjet dhe përmbytjet , ushqim i sigur dhe i garantuar .

### **Treguesit e performancës**

- ✓ Ritja e sigurisë së konsumatorëve
- ✓ Nr I rasteve të gjetura nga inspektorën në tegun bujqësor dhe blegtoral
- ✓ Nr I certifikatave të pronësisë të regjistruara .
- ✓ Nr I parcelave të mbjella me bimë .
- ✓ Nr I pritave që mbrojtjen e tokë bujqësore .

### **Aktivitetet**

Hartimi i planit të inspektiveve dhe kontrolleve në teren .

Hartimi I preventivave

Procedura prokurimi

Zbatim kontrate

### **Risku .**

Fatkeqësi natyrore në momentin e kryerjes së punimeve (demton punimet deri në fazen ku janë kryer ) .

**Kosto totale** = 6.115 mijë për vitin 2021 e ndarë ,55.445 mijë lekë paga +sigurime ,shpenzime operative 70 mijë dhe 600 mijë investime për pritat ,viti 2022= 6.145 mijë lekë , viti 2023=6.545 mijë lekë .

### **Rezultati**

Prodhime bujqësore dhe blegtorale më të ritura , toka më të mira dhe më funksionale , dhe siguri ushqimore e garantuar .

### **Impakti**

Ritje e nivelit të jetesë

### **04240 Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit**

1. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve , të ujitjes dhe\_kullimit , duke përfshirë grandet për punime të tilla .
2. Administrim ,shfrytësim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës se ujitjes dhe kullimit nën përgjegjesinë e njërive të vetqeverisjes vendore .

### **Qëllimi**

- ✓ Të përmirësojë shërbimin e ujitjes dhe kullimit nëpërmjet pastrimit dhe mirëmbajtjes së kanaleve dhe ujëmbledhësave me synim rritjen e prodhimeve bujqësore dhe mbrojtjen nga përmbytjet , duke pastruar 80 km kanal ujitës , duke ujitur 2300ha tokë dhe 30 km kanal kullues e cila do të përmirësojë kullimin në 450 ha tokë bujqësore për vitit 2021-2023.

### **Ojektivat .**

1. Përmirësimi i sistemit të ujitjes duke pastruar 25 km kanal ujitës për vitin 2021 e cila do të përmirësojë ujitjen në një sip prej 775 ha tokë bujqësore.
2. Përmirësimi i sistemit të kullimit duke pastruar 10 km kanal kullues për vitin 2021 e cila do të përmirësojë aftësinë kulluese në një sip prej 180 ha toke .
3. Përmirësimi i sistemit të ujitjes duke pastruar 27.8 km kanal ujitës për vitin 2022 e cila do të përmirësojë ujitjen në një sip prej 705 ha toke .
4. Përmirësimi i sistemit të kullimit duke pastruar 8 km kanal kullues për vitin 2022 e cila do të përmirësojë aftësinë kulluese në një sip prej 150 ha toke .
5. Përmirësimi i sistemit të ujitjes duke pastruar 27.2 km kanal ujitës për vitin 2023 e cila do të përmirësojë ujitjen në një sip prej 825 ha tokë bujqësore.
6. Përmirësimi i sistemit të kullimit duke 12 km kanal kullues për vitin 2023 e cila do të përmirësojë aftësinë kulluese në një sip prej 200ha tokë bujqësore .
